

INFORMACIONI PARAKONTRAKTOR

për shërbimet fikse të komunikimeve elektronike

Internet | Telefoni fikse | Abissnet TV

Lexojeni dhe ruajeni këtë dokument.

Ky dokument ju jep informacionin e plotë për ofertën përpara lidhjes së kontratës ose pranimit të saj. Ky dokument nuk është vetë kontrata dhe nuk zëvendëson "Përmbledhjen e Kontratës" sipas modelit të AKEP-it, e cila duhet t'ju dorëzohet veçmas, pa pagesë, përpara lidhjes së kontratës. Pas lidhjes së kontratës, informacioni parakontraktor bëhet pjesë përbërëse e saj dhe nuk ndryshohet, përveçse me marrëveshje të shprehur të palëve. Dokumenti duhet të dorëzohet i printuar, me e-mail ose në një mjet tjetër të qëndrueshëm që lejon ruajtjen dhe riprodhimin e pandryshuar të tij.

1. TË DHËNAT E DOKUMENTIT DHE KATEGORIA E PËRDORUESIT

Numri / kodi i ofertës	
Data e lëshimit	/ /
Oferta e vlefshme deri më	/ /
Pika e shitjes	
Mjeti i dorëzimit	☐ Letër ☐ E-mail ☐ Llogari online ☐ Mjet tjetër i qëndrueshëm:

2. IDENTITETI I OPERATORIT DHE KONTAKTET

Operatori	"Abissnet" sh.a.
NUIS	K01417001C
Selia / adresa postare	Rr. "Ismail Qemali", Pallati 18, Kati II, Tiranë, Shqipëri
Faqja elektronike	www.abissnet.al
Shërbimi ndaj klientit / defekte	044 300 001 (pa pagesë kur thirrja origjinohet nga një numër Abissnet)
E-mail për asistencë dhe ankesa	support@abissnet.al
WhatsApp / Viber	+355 68 900 0855
Pikat fizike	Abissnet Store - adresa dhe oraret sipas publikimit në www.abissnet.al
Kontakt për privatësinë	privacy@abissnet.al, +355 68 20 45 049

3. INDIVIDUALIZIMI I OFERTËS SË ZGJEDHUR

Emri i paketës / planit tarivor	
Shërbimet e përfshira	☐ Internet ☐ Telefoni fikse ☐ Abissnet TV ☐ Paketë e integruar
Adresa e instalimit	
Teknologjia e aksesit	☐ FTTH/FTTx ☐ Tjetër:
Data e parashikuar e aktivizimit	/ / ose brenda ditëve pune nga plotësimi i kushteve teknike

Cikli i faturimit	☐ Mujor ☐ Parapagim për periudhën: _____
Afati fillestar i zgjedhur	☐ 12 muaj ☐ 24 muaj (afati fillestar nuk mund të jetë më i gjatë se 24 muaj)
Niveli i suportit teknik	☐ SLA 1 ☐ SLA 2 ☐ SLA 3 ☐ Tjetër: _____

Rregull plotësimi:

Çdo fushë e këtij dokumenti që lidhet me ofertën konkrete duhet të plotësohet përpara nënshkrimit. Kur një element nuk zbatohet, shënohet "Nuk zbatohet"; nuk lihet bosh.

4. SHËRBIMET DHE KARAKTERISTIKAT KRYESORE

4.1 Shërbimi i aksesit në internet

Kjo pjesë plotësohet kur oferta përfshin internet fiks. Shërbimi siguron akses në internet në adresën e instalimit dhe nëpërmjet teknologjisë së shënuar në pikën 3. Performanca reale mund të ndikohet nga teknologjia, instalimi i brendshëm, pajisjet e përdoruesit, lidhja Wi-Fi, numri i pajisjeve aktive, serveri i destinacionit dhe ngarkesa e rrjeteve jashtë kontrollit të Abissnet.

Parametri i shpejtësisë	Shkarkim (Download)	Ngarkim (Upload)
Shpejtësia minimale	[____ Mbps]	[____ Mbps]
Shpejtësia normalisht e disponueshme	[____ Mbps]	[____ Mbps]
Shpejtësia maksimale	[____ Mbps]	[____ Mbps]
Shpejtësia e deklaruar / reklamuar	[____ Mbps]	[____ Mbps]

Periudha kur pritët shpejtësia normalisht e disponueshme	[p.sh. gjatë gjithë ditës / brezi orar: _____]
Periudha kur mund të arrihet shpejtësia maksimale	[_____]
Vonesa (latency), kur garantohet	[____ ms] / ☐ Nuk garantohet nivel minimal i veçantë
Luhatja kur garantohet	[____ ms] / ☐ Nuk garantohet nivel minimal i veçantë
Humbja e paketave, kur garantohet	[____ %] / ☐ Nuk garantohet nivel minimal i veçantë
Kufizim vëllimi / FUP	☐ Nuk ka ☐ Ka: [përshkrimi, pragu dhe pasoja: _____]

Shpejtësia minimale është niveli më i ulët që Abissnet merr përsipër të ofrojë, përveç ndërprerjeve të shërbimit; shpejtësia normalisht e disponueshme është niveli që pritët shumicën e kohës; shpejtësia maksimale është niveli që mund të arrihet të paktën një pjesë të kohës; shpejtësia e deklaruar është ajo e përdorur në komunikimin tregtar të ofertës.

Menaxhimi i trafikut, kufizimet dhe shërbimet e optimizuara

- Masat e zbatueshme për këtë ofertë: [Nuk zbatohen masa të veçanta / përshkruani masën, arsyen, kohëzgjatjen dhe ndikimin: _____].
- Abissnet do të zbatojë masa të arsyeshme, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale për përmbushjen e detyrimeve ligjore, ruajtjen e integritetit dhe sigurisë së rrjetit, parandalimin e mbingarkesës së përkohshme ose trajtimin e incidenteve. Masat nuk duhet të zgjasin më shumë se sa është e nevojshme.
- Kufizimet e volumit, shpejtësisë ose parametrave të tjerë dhe ndikimi i tyre në përdorimin e përmbajtjes, aplikacioneve dhe shërbimeve duhet të përshkruhen në fushën përkatëse më sipër.

- Shërbime të optimizuara / të specializuara të lidhura me ofertën: [Abissnet TV / tjetër: _____]. Ndikimi i mundshëm mbi internetin: [nuk ka ndikim të matshëm / mund të përdorë pjesë të kapacitetit gjatë përdorimit të njëkohshëm / përshkrim tjetër: _____].
- Përdoruesi mund të përdorë pajisje fundore sipas zgjedhjes së tij, kur ato janë teknikisht të pajtueshme dhe nuk cenojnë sigurinë ose integritetin e rrjetit. Parametrat teknikë që duhen respektuar: _____.

4.2 Shërbimi telefonik fiks

Kjo pjesë plotësohet kur oferta përfshin shërbim komunikimi zanor nga vendndodhje fikse.

Numri telefonik	☐ Numër i ri: [_____] ☐ Numër për t'u portuar: [_____]
Shërbimet e përfshira	☐ Thirrje hyrëse ☐ Thirrje dalëse kombëtare ☐ Thirrje ndërkombëtare
Minuta të përfshira	[____] minuta / periudhë faturimi] ose ☐ Pa minuta të përfshira
Tarifa jashtë paketës	Sipas Aneksit "Lista e shërbimeve dhe çmimeve", versioni/datë: [_____]
Numra me tarifim të veçantë	[Kategoritë, tarifa dhe mënyra e informimit: _____]
Shërbimet e emergjencës	Thirrjet drejt numrave të emergjencës janë pa pagesë. Kufizime teknike për aksesin ose informacionin e vendndodhjes: ☐ Nuk ka ☐ Ka: _____
Numërori telefonik	Përfshirja bëhet vetëm sipas zgjedhjes së pajtimtarit dhe për të dhënat e përcaktuara prej tij.

4.3 Abissnet TV

Abissnet TV është shërbim audioviziv OTT që mundëson marrjen e programeve të palëve të treta nëpërmjet internetit dhe dekoderit/aplikacionit të përcaktuar në ofertë. Disponueshmëria e kanaleve dhe përmbajtjes varet edhe nga të drejtat e transmetimit dhe marrëdhëniet me ofruesit e përmbajtjes.

Paketa televizive	[_____]
Lista e kanaleve / përmbajtjes	Dokumenti ose lidhja: [_____] Versioni/datë: [_____]
Pajisja / aplikacioni	☐ Dekoder Abissnet TV (Android) ☐ Aplikacion ☐ Tjetër: _____
Pajisje, kufizime dhe kontroll prindëror	Pajisje/ekrane: [_____] Kufizime teknike/gjeografike: [_____] Kontroll prindëror/PIN: [_____]

Ndryshimet materiale që pakësojnë shërbimin e kontraktuar njoftohen sipas rregullave për ndryshimin e kushteve kontraktore. Kur shërbimi televiziv është pjesë e një pakete që përmban internet ose telefoni fikse, të drejtat për paketën zbatohen sipas ligjit nr. 54/2024 "Per komunikimet elektronike RSH"

5. PAJISJET FUNDOR, INSTALIMI DHE AKTIVIZIMI

Pajisjet që jepen në me qira ose në shitje. Numri serial/MAC regjistrohet në momentin e dorëzimit.

Pajisja	Regjimi juridik	Tarifa / çmimi me TVSH	Vlera e deklaruar	Kthimi / kushtet
Router / modem	☐ Pronë e Abissnet ☐ Shitje	[_____] lekë]	[_____] lekë]	[afati, gjendja, tarifa: _____]
Dekoder Abissnet TV	☐ Pronë e Abissnet ☐ Shitje	[_____] lekë]	[_____] lekë]	[afati, gjendja, tarifa: _____]
Pajisje tjetër: _____	☐ Pronë e Abissnet ☐ Shitje ☐ E subvencionuar	[_____] lekë]	[_____] lekë]	[_____] _____]

- Kostoja e instalimit: [_____] lekë me TVSH]. Tarifa e aktivizimit: [_____] lekë me TVSH].

- Punimet standarde të përfshira: [_____]. Punimet ose materialet shtesë, vetëm me miratimin paraprak të pajtimtarit: [tarifat / mënyra e llogaritjes: _____].
- Aktivizimi kryhet pasi të jenë plotësuar kushtet teknike, të jetë siguruar akses në ambient dhe të jenë marrë lejet e nevojshme për zonat e përbashkëta. Nëse instalimi nuk është teknikisht i mundur, Abissnet njofton përdoruesin dhe kthen pagesën.
- Në përfundim të kontratës, pajisjet në pronësi të Abissnet kthehen brenda [____] ditëve, në adresën [_____]. Dëmtimi, humbja ose moskthimi mund të sjellë detyrimin e kompensimit sipas vlerës së deklaruar dhe amortizimit të përcaktuar në kontratë.
- Nëse pajtimtari, gjatë përfundimit të parakohshëm, zgjedh të mbajë pajisjen fundore të përfshirë në paketë, kompensimi nuk mund të kalojë vlerën më të ulët ndërmjet vlerës proporcionale të pajisjes dhe pjesës së tarifës së shërbimit për muajt e mbetur. Kufizimet e përdorimit në rrjete të tjera hiqen pa pagesë jo më vonë se data e shlyerjes së kompensimit për pajisjen.

6. CILËSIA, MIRËMBAJTJA DHE ASISTENCA TEKNIKE

Niveli i suportit teknik që zbatohet për ofertën shënohet në pikën 3. Afatet e mëposhtme merren nga Kontrata Tip dhe plotësohen/konfirmohen në ofertën individuale:

Niveli	Koha maksimale e përgjigjes	Koha maksimale e zgjidhjes
SLA 1	30 minuta	48 orë
SLA 2	15 minuta	12 orë
SLA 3	10 minuta	6 orë

- Raportimi i defektit: 044 300 001, support@abissnet.al, WhatsApp/Viber +355 68 900 0855 ose Abissnet Store. Pajtimtari merr numër reference për ankesën/raportimin e regjistruar.
- Mirëmbajtja e planifikuar njoftohet, kur është e mundur, të paktën 48 orë përpara. Për ndërhyrje urgjente, incidente sigurie ose rrethana të forcës madhore, njoftimi paraprak mund të mos jetë i mundur.
- Kur cilësia e kontraktuar nuk përmbushet ose riparimi i defektit në rrjetin e Abissnet tejkalon afatin e zbatueshëm, Abissnet zbaton ulje proporcionale të tarifës në faturën pasardhëse për periudhën e mungesës së cilësisë/vonesës, pa cenuar mjetet e tjera juridike.
- Në rast mospërputhjeje të rëndësishme, të vazhdueshme ose të përsëritur rregullisht ndërmjet performancës reale dhe asaj të kontraktuar, përdoruesi mund të kërkojë verifikim, korrigjim, kompensim dhe, kur plotësohen kushtet ligjore, zgjidhjen e kontratës pa kosto. Për internetin, matjet vlerësohen sipas metodologjisë dhe mekanizmit të certifikuar nga AKEP, kur ky mekanizëm është i disponueshëm.

7. ÇMIMET, TARIFAT DHE MËNYRA E PAGESËS

Të gjitha shumat më poshtë shënohen me TVSH. Për tarifat që varen nga konsumi ose destinacioni, dokumenti referues duhet të identifikohet me emër, version dhe datë.

Elementi i çmimit	Shuma me TVSH	Periodiciteti / kohëzgjatja	Kushti ose dokumenti referues
Tarifa e pajtimit	[_____] lekë	☐ mujore ☐ tjetër: _____	[_____]
Tarifa promotionale	[_____] lekë	nga [_____] deri [_____] / për [_____] muaj	Më pas zbatohet tarifa standarde
Aktivizimi	[_____] lekë	një herë	[_____]
Instalimi	[_____] lekë	një herë	[_____]
Qiraja e pajisjes	[_____] lekë	☐ mujore ☐ tjetër: _____	Pajisja: _____
Mirëmbajtja / suporti	[_____] lekë	☐ përfshirë ☐ mujore ☐ sipas rastit	[_____]
Riaktivizimi pas pezullimit	[_____] lekë	për çdo riaktivizim	[_____]
Transferimi i linjës	[_____] lekë	sipas kërkesës	plus pajisje/punime të nevojshme

Elementi i çmimit	Shuma me TVSH	Periodiciteti / kohëzgjatja	Kushti ose dokumenti referues
Tarifa jashtë paketës	Sipas listës	sipas konsumit	"Lista e shërbimeve dhe çmimeve", version/datë: _____
Tarifa tjetër: _____	[_____ lekë]	[_____]	[_____]

- Çmimet e elementeve të paketës, kur tregtohen edhe veçmas: Internet [_____ lekë]; Telefoni fikse [_____ lekë]; Abissnet TV [_____ lekë]; Pajisja [_____ lekë].
- Mënyrat e pagesës: në Abissnet Store me para në dorë brenda kufijve ligjorë, me transfertë bankare, online në www.abissnet.al ose nëpërmjet institucioneve të parasë elektronike të publikuara nga Abissnet.
- Afati i pagesës: [data / rregulli: _____]. Abissnet njofton pajtimtarin për detyrimin dhe masat e mundshme kufizuese sipas kontratës. Në rast mospagese, nderpritet shërbimi, aksesit në numrat e emergjencës nuk kufizohet.
- Fatura tregon periudhën e faturimit, tarifën fikse, shërbimet dhe çdo pagesë tjetër. Për shërbimin telefonik, pajtimtari mund të kërkojë pa pagesë faturë të detajuar, me respektimin e privatësisë së komunikimeve.
- Kur shërbimi faturohet sipas kohës ose sasisë së konsumuar, Abissnet ofron mjet për monitorimin e konsumit dhe njoftim përpara arritjes dhe pas konsumimit të plotë të kufirit të përfshirë në plan, kur zbatohet.
- Informacioni i përditësuar për tarifat: www.abissnet.al dhe Aneksi "Lista e shërbimeve dhe çmimeve". Në rast mospërputhjeje, zbatohen çmimet e individualizuara në ofertën dhe dokumentet e dorëzuara pajtimtarit, pa cenuar ndryshimet e vlefshme të bëra sipas ligjit.

8. KOHËZGJATJA, RINOVIMI, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI

8.1 Afati dhe fillimi

- Afati fillestar i zgjedhur është [12 / 24] muaj dhe fillon në datën e aktivizimit të shërbimit: [____ / ____ / ____]. Abissnet duhet t'i ofrojë konsumatorit edhe mundësinë e një kontrate me kohëzgjatje jo më të madhe se 12 muaj; afati fillestar nuk mund të kalojë 24 muaj.
- Rinovimi për një periudhë tjetër të caktuar kërkon pëlqimin e shprehur të pajtimtarit. Nëse kontrata vazhdon me afat të pacaktuar pas mbarimit të afatit fillestar, pajtimtari mund ta zgjidhë në çdo kohë me njoftim paraprak jo më të gjatë se një muaj dhe pa kosto tjetër, përveç tarifës së shërbimit gjatë periudhës së njoftimit.
- Përpara përfundimit/zgjatjes së kontratës, Abissnet njofton pajtimtarin në mjet të qëndrueshëm për datën e përfundimit, mënyrën e zgjidhjes, tarifën që do të zbatohet dhe opsionet/tarifat më të mira të disponueshme. Këshilla për tarifat më të mira jepet të paktën çdo vit.

8.2 Pezullimi me kërkesë të pajtimtarit

- Kërkesa bëhet me shkrim të paktën 10 ditë kalendrike përpara. Pezullimi mund të kërkohej jo më shumë se dy herë në vit dhe jo më shumë se tre muaj gjithsej, sipas Kontratës Tip.
- Gjatë pezullimit nuk aplikohet tarifa mujore e shërbimit. Për paketat e shërbimeve të lidhura, pezullimi mund të zbatohet për të gjithë paketën. Tarifa e riaktivizimit, nëse ka, është ajo e shënuar në pikën 7.

8.3 Ndryshimi i kushteve nga Abissnet

- Pajtimtari njoftohet qartë, në mjet të qëndrueshëm, të paktën një muaj përpara hyrjes në fuqi të ndryshimit dhe informohet për të drejtën e zgjidhjes pa kosto, kur nuk i pranon kushtet e reja.
- E drejta e zgjidhjes pa kosto nuk zbatohet kur ndryshimi është vetëm në dobi të pajtimtarit, është administrativ pa efekt negativ, ose kërkohej drejtpërdrejt nga legjislacioni. Uljet e çmimeve dhe përmirësimet e cilësisë mund të zbatohen menjëherë.

8.4 Përfundimi i parakohshëm

- Kur pajtimtari përfundon vullnetarisht një kontratë me afat të caktuar pa një shkak që i jep të drejtën e zgjidhjes pa kosto, mund të zbatohet kompensim proporcional. Sipas Kontratës Tip, kompensimi nuk duhet të jetë më i lartë se vlera më e ulët ndërmjet: (a) tarifave bazë mujore për muajt e mbetur; dhe (b) diferencës ndërmjet shpenzimit minimal të angazhuar dhe shpenzimit të kryer deri në përfundim, kur ekziston një angazhim i tillë.

- Kur ligji i jep pajtimtarit të drejtën të zgjidhë kontratën përpara afatit - për shembull për ndryshim të pafavorshëm të kushteve ose mospërputhje të rëndësishme dhe të vazhdueshme - nuk paguhet kompensim për zgjidhjen, përveç detyrimeve të mbetura për pajisjen fundore që pajtimtari zgjedh të mbajë.
- Përfundimi nuk shuan detyrimet e krijuara përpara datës së përfundimit, përfshirë faturat e papaguara, përdorimin deri në çaktivizim dhe kthimin e pajisjeve.
- Në një paketë që përfshin internet ose telefoni, kur pajtimtari ka të drejtë të përfundojë një element për shkak të mospërbushjes ose dështimit të shërbimit, ai mund të përfundojë të gjithë paketën. Shtimi i një shërbimi ose pajisjeje nuk e zgjat afatin ekzistues, përveçse kur pajtimtari pranon shprehimisht.

9. NDËRRIMI I OFRUESIT DHE PORTABILITETI I NUMRIT

9.1 Portabiliteti i numrit fiks

- Pajtimtari mund të mbajë numrin fiks kur ndryshon ofruesin, brenda së njëjtës zonë gjeografike të numeracionit. Kërkesa paraqitet te operatori marrës, i cili drejton procesin.
- Numri mund të portohet kur është aktiv ose, nëse është çaktivizuar pas përfundimit të kontratës, brenda afatit të paktën njëmuor, përveç rastit kur pajtimtari ka hequr dorë nga kjo e drejtë.
- Operatori marrës verifikon identitetin, dorëzon kopje të kërkesës dhe e hedh kërkesën në sistemin përkatës jo më vonë se një ditë pune nga depozitimi. Ai informon pajtimtarin për afatet, aktivizimin, arsyet e mundshme të refuzimit ose vonës dhe pajtueshmërinë e pajisjeve.
- Portimi i një numri aktiv sjell përfundimin e kontratës ekzistuese që lidhet me atë numër, por nuk shuan detyrimet financiare ose detyrimet për pajisjet. Kur numri është pjesë e një pakete, pasojat mbi shërbimet e tjera duhet të sqarohen dhe individualizohen përpara kërkesës së portimit.
- Detyrimet që mund të kërkojnë përpara portimit përfshijnë faturat e papaguara dhe, kur zbatohet, kompensimin për përfundimin para afatit, detyrimet për përdorimin deri në datën e portimit dhe kthimin e pajisjeve mund të faturohen/përbushen në ose pas përfundimit, sipas rregullores së AKEP-it.

Numri që kërkohet të portohet	
Operatori dhënës	
Data e kërkuar e portimit	
Ndikimi mbi shërbimet e tjera të paketës	

10. SIGURIA, INTEGRITETI I RRJETIT DHE PËRDORIMI I LIGJSHËM

- Pajtimtari duhet të mbrojë kredencialet dhe pajisjet e tij, të mos ndërhyjë pa autorizim në pajisjet ose rrjetin e Abissnet, të mos rishesë shërbimin pa të drejtë dhe të mos e përdorë për veprimtari të paligjshme, trafik artificial, spam, komunikime kërcënuese ose cenim të të drejtave të të tretëve.
- Abissnet mund të marrë masa të arsyeshme dhe proporcionale - deri në kufizim ose pezullim - për t'iu përgjigjur incidenteve të sigurisë, kërcënimeve, cenueshmërive, mashtrimit, abuzimit, mospagesës ose rrezikut serioz për rrjetin. Kur është teknikisht e mundur, masa kufizohet te shërbimi i prekur dhe pajtimtari njoftohet, përveç rasteve urgjente kur njoftimi do të cenonte sigurinë ose kërkohet veprim i menjëhershëm.
- Kur përgjigjja e Abissnet ndaj një incidenti, kërcënimi ose cenueshmërie është e papërshtatshme dhe shkakton mospërbushje të nivelit të kontraktuar, zbatohen mekanizmat e ankesës, kompensimit dhe mjetet juridike të parashikuara në kontratë dhe ligj.
- Abissnet nuk kontrollon përmbajtjen e komunikimeve dhe nuk kryen përgjim. Përgjimi ose dhënia e të dhënave autoriteteve kryhet vetëm nga organet kompetente dhe sipas procedurave ligjore.

11. TË DHËNAT PERSONALE, PRIVATËSIA DHE KOMUNIKIMET TREGTARE

Përpara aktivizimit dhe gjatë ofrimit të shërbimit, Abissnet mund të përpunojë të dhëna vetëm për qëllime të përcaktuara, të ligjshme dhe transparente. Informacioni i plotë jepet në Njoftimin e Privatësisë, i cili identifikohet më poshtë.

Kategoria	Shembuj	Qëllimi kryesor
Identifikim dhe kontakt	Emër, mbiemër, numër identifikimi, adresë, telefon, e-mail	Lidhja dhe administrimi i kontratës; identifikimi
Kontraktore dhe financiare	Paketa, adresa e instalimit, faturat, pagesat, detyrimet	Faturimi, pagesat, kontabiliteti dhe menaxhimi i marrëdhënies
Teknike dhe përdorimi	Numri, IP, identifikues pajisjeje, të dhëna trafiku sipas ligjit, incidente	Ofrimi i shërbimit, diagnostikimi, siguria, parandalimi i abuzimit
Komunikime dhe ankesa	Regjistrime kërkesash, korrespondencë, numër reference	Asistenca, trajtimi i ankesave dhe prova e komunikimit
Aksesueshmëri	Të dhëna të dhëna vullnetarisht për përshtatjen e shërbimit	Ofrimi i formateve/kanaleve të përshtatshme, me mbrojtje të shtuar

- Baza ligjore mund të jetë zbatimi i kontratës dhe hapave parakontraktore, përmbushja e detyrimeve ligjore, interesat e ligjshëm të sigurisë dhe administrimit, ose pëlqimi kur kërkohet. Marketingu i drejtpërdrejtë dhe publikimi në numëratortrajtohen veçmas dhe mund të kundërshtohen dhe revokohen sipas ligjit.
- Të dhënat mund t'u komunikohen përpunuesve, ofruesve teknikë, partnerëve të pagesave, nënkontraktorëve të instalimit dhe mirëmbajtjes dhe autoriteteve kompetente, vetëm në masën e nevojshme dhe me garancitë ligjore.
- Të dhënat ruhen për kohën e nevojshme për qëllimin përkatës dhe për afatet ligjore të faturimit, kontabilitetit, sigurisë, ruajtjes së të dhënave dhe mbrojtjes së pretendimeve. Afatet konkrete jepen në Njoftimin e Privatësisë.
- Subjekti i të dhënave mund të kërkojë akses, korrigjim, fshirje, kufizim, kundërshtim, transferim kur zbatohet, tërheqje të pëlqimit dhe të paraqesë ankesë të Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Njoftimi i Privatësisë	Titulli/versioni/data ose lidhja: [_____]
Kontakt për ushtrimin e të drejtave	[_____]
Marketing i drejtpërdrejtë	☐ Nuk jap pëlqim ☐ Jap pëlqim sipas formularit të veçantë; mund ta tërheq në çdo kohë
Përfshirja në numëratort	☐ Jo ☐ Po, vetëm këto të dhëna: _____

12. AKSESUESHMËRIA PËR PËRDORUESIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

- Ky dokument, Përmbledhja e Kontratës, kontrata dhe informacioni publik mund të kërkohen në format të aksesueshëm, ose format tjetër të përshtatshëm të disponueshëm.
- Kanalet e preferuara të komunikimit dhe përshtatjet e nevojshme regjistrohen vetëm me kërkesën e përdoruesit dhe përdoren për trajtim të barabartë e jodiskriminues.

Formati i kërkuar	☐ Standard ☐ Large print ☐ Format elektronik i aksesueshëm ☐ Tjetër: _____
Kanali i preferuar	☐ Telefon ☐ SMS ☐ E-mail ☐ Përfaqësues i autorizuar ☐ Tjetër: _____
Shërbime të posaçme	[_____]
Mënyra e marrjes së përditësimeve	[_____]

13. ANKESAT, KOMPENSIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Pajtimtari mund të kërkojë sqarime ose të paraqesë ankesë për kushtet kontraktore, faturimin, cilësinë, defektet, internetin e hapur, portabilitetin, privatësinë ose çdo aspekt tjetër të shërbimit.

Kanali	Të dhënat
Telefon	044 300 001 - "Defekte dhe asistencë teknike"
Në pikë fizike	Abissnet Store; ankesa regjistrohet me shkrim
Postë	Rr. "Ismail Qemali", Pallati 18, Kati II, Tiranë, Shqipëri
E-mail	support@abissnet.al
WhatsApp / Viber	+355 68 900 0855

- Ankesa për shumën e faturuar paraqitet brenda 15 ditëve nga marrja e faturës, ankesa për cilësinë paraqitet brenda 15 ditëve nga ofrimi i shërbimit. Defekti raportohet menjëherë, ankesat e tjera paraqiten sa më shpejt.
- Abissnet konfirmon marrjen, jep numër reference dhe përgjigjet me shkrim jo më vonë se 15 ditë nga marrja e ankesës së shkruar, sipas rregullave në fuqi.
- Kur ankesa pranohet, zgjidhja mund të përfshijë korrigjim fature, riparim, rikthim shërbimi, ulje proporcionale të tarifës, rimbursim ose masë tjetër të përshtatshme. Kundërshtimi i një fature trajtohet sipas kushteve të kontratës dhe nuk i heq pajtimtarit të drejtën për zgjidhje alternative ose gjyqësore.
- Nëse pajtimtari nuk është dakord me përgjigjen, mund t'i drejtohet AKEP-it për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, nëpërmjet protokollit, postës ose modulit "e-ankesa" në www.akep.al, ose gjykatës kompetente. Për çështjet e të dhënave personale mund t'i drejtohet edhe Komisionerit.

14. DOKUMENTET QË I DORËZOHEN PËRDORUESIT PËRPARA KONTRATËS

- ☐ Ky Informacion Parakontraktor ☐ Përmbledhja e Kontratës sipas modelit AKEP ☐ Kontrata Tip / Kushtet e Përgjithshme
- ☐ Formulari i Regjistrimit / oferta individuale ☐ Aneksi "Lista e shërbimeve dhe çmimeve" ☐ Lista e kanaleve të Abissnet TV
- ☐ Treguesit e cilësisë / shpejtësitë e internetit ☐ Udhëzuesi i ankesave ☐ Njoftimi i Privatësisë ☐ Kushtet e pajisjeve

Dokument tjetër	[_____]
Versionet dhe datat e dokumenteve	[_____]
Lidhja elektronike ku ruhen/shkarkohen	[_____]

16. DEKLARIMI I MARRJES SË INFORMACIONIT

Nënshkrimi më poshtë vërteton vetëm marrjen e këtij informacioni parakontraktor dhe të dokumenteve të shënuara, jo lidhjen e kontratës. Kontrata lidhet nëpërmjet nënshkrimit ose mënyrës tjetër të vlefshme të pranimit të dokumenteve kontraktore. Nëse Përmbledhja e Kontratës nuk mund të jepet menjëherë për arsye objektive teknike, kontrata bëhet efektive vetëm pasi përdoruesi e merr dhe konfirmon dakordësinë.

Përdoruesi	Përfaqësuesi i Abissnet
Emër, mbiemër / subjekt: _____	Emër, mbiemër: _____
Nënshkrimi: _____	Nënshkrimi: _____
Data dhe ora: _____	Data dhe ora: _____